

Cilat rregulla vlejné në lidhje me kufizimet e kontakteve sociale?

Këto rregulla mbeten në fuqi në lidhje me kufizimet e kontakteve sociale: Takimet private në hapësira publike gjatë të cilave nuk respektohet rregulli për mbajtjen e distancës do të reduktohen në takime vetëm midis pjesëtarëve të bashkësive familjare të një personi dhe të një tjetri. Nuk lejohet të jenë të pranishëm më shumë se 5 persona dhe fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë) nuk numërohen kur llogaritet numri i personave.

Nga data 24 dhjetor deri në datën 26 dhjetor vlejné përjashtimet e përshkruara më poshtë.

Me sa persona mund të takohem gjatë Krishtlindjeve dhe Vigjiljes së Vitit të Ri ?

Nga data 24 dhjetor deri në datën 26 dhjetor mund të marrin pjesë në takim krahas personave të një bashkësie familjare, edhe 4 persona shtesë nga rrethi i ngushtë familjar. Këtu nuk përfshihen sërish fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë). Tek rrethi i ngushtë familjar përfshihen: Bashkëshortë e bashkëshorte, partnerë e partnere jete, partnerë të cilët bashkëjetojnë dhe nuk janë të lidhur me martesë, të afërm të cilët rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga njëri tjetri, vëllezër e motra, nipër e mbesa. Pjesëtarët e bashkësisë së tyre familjare mund të jenë gjithashtu të pranishëm, për sa kohë që numri i personave mbi moshën 14 vjeç jashtë bashkësisë familjare së vetë personit nuk i kalon 4.

Për Vigjiljen e Vitit të Ri dhe ditën e parë të Vitit të Ri vlejné këto rregulla: Takimet private në hapësira publike duhet të kufizohen midis bashkësive familjare të një personi dhe të një tjetri. Nuk lejohet të jenë të pranishëm më shumë se 5 persona dhe fëmijët deri në moshën 14 vjeç (duke e përfshirë këtë moshë) nuk numërohen kur llogaritet numri i personave.

Si është situata ligjore në sektorin e gastronomisë dhe të bizneseve të cilat ofrojnë qëndrim gjatë gjithë natës?

Restorantet dhe tavernat qëndrojnë të mbyllura. Lejohen vetëm shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit ose tavernës. Gjithashtu janë të ndaluara qëndrimet gjatë gjithë natës për qëllime turistike. Qëndrimet gjatë gjithë natës për qëllime biznesi dhe shërbimi nuk konsiderohen për qëllime turistike.

Ku mund të konsumohet alkooli?

Nga data 16 dhjetor deri në datën 10 Janar ndalohet konsumi i pijeve alkoolike në hapësira publike.

A do mbyllen dyqanet e shitjes me pakicë?

Po. Dyqanet e shitjes me pakicë do të mbyllen duke filluar nga data 16 dhjetor. Këtu përjashtohen: Dyqanet ku shiten artikuj ushqimorë, shërbimet ku produktet dërgohen tek konsumatori ose ku merren nga ai me vete për t'u konsumuar jashtë ambienteve të restorantit

ose tavernës, dyqanet ku shiten pije, tregjet javore të produkteve të freskëta, farmacitë, dyqanet të cilat shesin produkte të shëndetshme, dyqanet të cilat shërbejnë për furnizimin me artikuj mjekësorë, dyqanet ku shiten artikuj për bebe, barnatoret, pikat e karburantit, bankat, bankat e kursimit, zyrat postare, kioskat dhe pikat ku shiten gazetatat, dyqanet ku shiten produkte ushqimore dhe për kujdesin e kafshëve, pikat ku shiten pemë krishtlindje, pikat e shitjes me shumicë (për klientët e pikave të shitjes me shumicë), shpërndarja e ushqimeve nëpërmjet institucioneve sociale (bankave e ushqimit).

A është e mundur dërgesa e produkteve tek klientët dhe marrja e produkteve nga vetë klientët?

Po. Porositja e produkteve dhe dërgesa e tyre në shtëpi është e lejuar. Marrja e produkteve nga klientët lejohet vetëm nëse mund të ndodhë pa kontakt fizik dhe duke respektuar masat për mbrojtjen nga infeksionet.

A lejohet hapja e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive?

Veprimtaria e dyqaneve ku shiten produkte për rregullimin e shtëpive dhe për kopshte lejohet vetëm për të furnizuar personat e vetëpunësuar të cilët kanë një biznes. Personat e tjerë nuk lejohen të hyjnë.

A ka ndryshime në lidhje me detyrimin për mbajtjen e maskës?

Jo, detyrimet për mbajtjen e maskës vazhdojnë të vlejnjë, veçanërisht në hapësirat e mëposhtme:

- në hapësira të mbyllura të cilat janë të disponueshme për publikun, ose për klientë dhe vizitorë, gjithashtu dhe për transportin publik (ku përfshihen dhe stacionet e autobuzave),
- tek tregjet ushqimore ose pika të ngjashme shitje në mjedise të hapura,
- tek dyqanet e shitjes me pakicë dhe tek vendet e parkimit dhe rrugët e tyre,
- nëse është e nevojshme, dhe tek mjediset ku punohet dhe ushtrohen veprimtari, por jo në rastin kur mbahet distanca minimale.

A do të qëndrojnë hapur shkollat?

Shkollat do të qëndrojnë hapur deri në 18 dhjetor. Vazhdon të qëndrojë në fuqi detyrimi për t'u shkolluar. Detyrimi për t'u paraqitur në shkolla është hequr. Prindërit e fëmijëve nga klasa e parë deri në klasën e shtatë duhet ta vendosin vetë, nëse fëmija duhet të paraqitet fizikisht në klasë ose nëse do të mësojë në shtëpi. Duke filluar nga klasa e tetë, mësimet do të zhvillohen në distancë.

Informacione të mëtejshme i gjeni tek www.msb.nrw

Kur i fillojnë shkollat pushimet e Krishtlindjeve?

Mësimi do të zhvillohet deri në 18 dhjetor. Pastaj do të fillojnë pushimet. Nga data 7 janar deri në datën 8 janar nuk do të zhvillohet mësim.

A do të mbyllet sektori për kujdesin ditor të fëmijëve?

Jo, shërbimet për kujdesin ditor të fëmijëve do të qëndrojnë të hapura në thelb. Nuk do të jetë e ndaluar hyrja tek to si në pranverë. Për kujdesin ndaj fëmijëve garantohen këto pika: I ofrohet përkujdesje fëmijëve për të cilët është i domosdoshëm frekuentimi i mjediseve të kujdesit ditor ndaj fëmijëve. Prindërit të cilët kanë mundësinë të kujdesen për fëmijët në shtëpi, janë të lutur ta bëjnë këtë gjë në javët në vazhdim. Gjithsesi, nëse prindërit kanë nevojë për ndihmë dhe përkujdesje, atyre do t'u vendosen në dispozicion këto shërbime. Informacione të mëtejshme mund t'i gjeni tek faqja e internetit e Ministrisë së Fëmijëve dhe Familjes: <https://www.mkffi.nrw/lockdown-hinweise-fuer-die-kindertagesbetreuung-vom-1412-bis-101>

A ndalohet hedhja e fishekzjarrëve në Vigjiljen e Vitit të Ri?

Hedhja e fishekzjarrëve do të ndalohet në rrugë dhe sheshe plot me njerëz (përcaktimi më konkret do të bëhet nga komunat). Rekomandohet urgjentisht të hiqet dorë nga hedhja e fishekzjarrëve në shtëpi, dhe që të mos ndizen fishekzjarrët e blerë tashmë. Kjo do të mund të parandalojë plagosje të cilat do ta mbingarkonin edhe më shumë seç është i mbingarkuar sistemin shëndetësor. Ndalohet gjithashtu menjëherë shitja e fishekzjarrëve.

Çfarë do të ndodhë me institucionet kulturore?

Koncertet dhe shfaqjet në teatro, opera dhe salla koncerti, kinema dhe institucione të tjera kulturore private ose publike ndalohen minimalisht deri në 10 janar 2021. E njëjta gjë vlen dhe për veprimtarinë e muzeve, ekspozitave artistike, galerive, kështjellave, përmendoreve dhe mjediseve të ngjashme. I lejohet veprimtaria vetëm kinemave nën qiell të hapur ku shihen filma nga makina, për sa kohë që mbahet distanca prej 1.5 metrash midis makinave.

Cilat rregulla vlejné për muzikantët profesionistë?

Lejohet veprimtaria provë, e cila është pjesë e ushtrimit të profesionit. Gjithashtu i lejohet muzikantëve profesionistë, të zhvillojnë koncerte dhe shfaqje pa audiencë me qëllim regjistrimin e tyre ose për t'u transmetuar në radio dhe internet.

Cilat rregulla vlejné për sportet amatore dhe të kohës së lirë?

Ndalohet veprimtaria e sporteve amatore dhe të kohës së lirë në mjediset publike dhe private të sporteve, palestrave, pishinave dhe në mjedise të ngjashme, njëlloj si në pranverë. Kjo vlen

gjithashtu dhe për sportet individuale në mjedise sportive / klube sportive, si tenisi dhe golfi. Lejohen vrapimi dhe ecja duke respektuar kufizimin e kontaktit fizik.

Cilat rregulla vlejné për sportet e shkollave?

Lejohen sportet në shkolla, trajnimi në sportet praktike si pjesë e programeve mësimore, trajnimi në bazat federale të Nordrhein-Westfalen dhe në bazat e Landit ku zhvillohet trajnimi për performanca të nivelit të lartë.

Çfarë do të ndodhë me mjediset e kohës së lirë dhe të argëtimit?

Deri në 10 janar 2021 ndalohet veprimtaria e

- pishinave për notim e argëtim, saunave dhe banjave termale, si dhe gjithashtu veprimtaria e mjediseve të ngjashme,
- kopshteve zoologjike, parqeve të kafshëve, parqeve të kohës së lirë, mjediseve të brendshme të argëtimit dhe mjediseve të ngjashme për shpenzimin e kohës së lirë (brenda dhe jashtë),
- sallave të lojërave, kazinove dhe mjediseve të ngjashme,
- klubeve, diskotekave dhe mjediseve të ngjashme,
- bordellove, mjediseve ku zhvillohet prostitucioni dhe mjediseve të ngjashme,
- ekskursioneve me anije, karroca, trena historikë dhe mjediseve të ngjashme.

Në pikat dhe bizneset e basteve, lejohet vetëm marrja e biletave, basteve, etj. Nuk lejohet qëndrimi i mëtejshëm (për shembull për të parë lojëra dhe evenimente të cilat lidhen me bastet).

A lejohen ende evenimentet dhe mbledhjet?

Evenimentet dhe mbledhjet, të cilat nuk bëjnë pjesë tek rregulloret speciale të Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, ndalohen të paktën deri në 10 janar 2021.

Lejohen ndër të tjera nën kushte të cilat përcaktohen sipas rastit:

- Mbledhjet sipas ligjit për mbledhjet (për shembull demonstratat, duke përjashtuar datat 31 dhjetor 2021 dhe 1 janar 2021)
- Evenimentet të cilat i shërbejnë nevojave thelbësore të popullatës, mirëmbajtjes së sigurisë dhe rendit publik ose evenimentet të cilat sigurojnë mirëqenien e publikut (për shembull mbledhjet partiake për nominimin e kandidatëve elektorale ose dhurimet e gjakut) të cilat nuk mund të shtyhen për një periudhë pas 10 janar 2021 për arsye ligjore ose faktuale
- Mbledhjet e komiteteve ligjore, shoqërive, partive, klubeve, shoqatave të pronarëve të shtëpive, të cilat nuk zhvillohen dot dixhitalisht
- Varrimet
- Ceremonitë civile
- Shërbimet fetare

Cilat rregulla vlejné për shërbimet fetare dhe mbledhje të tjera në lidhje me ushtrimin e besimit fetar?

Kishat dhe komunitetet fetare e vendosin deri në çfarë pike mund të mblidhen njerëzit fizikisht, duke pasur parasysh situatën lokale të infeksionit dhe duke informuar autoritetet përgjegjëse vendore. Ata sigurojnë mbajtjen e distancës minimale, kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, paraqitjen e kërkesës për regjistrim për ato mbledhje ku pritët një numër i tillë vizitorësh i cili mund ta kalojë kapacitetin, i kërkojnë pjesëmarrësve të mbajnë një maskë kur ulen, regjistrojnë të dhënat e kontaktit të pjesëmarrësve dhe ndalojnë këndimin në kongregacion.

Rregulloret e përgatitura nga organizatat gjithëpërfshirëse sipas § 1 Paragrafi nr.3 i Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi nga kishat dhe komunitetet fetare për shërbimet fetare dhe mbledhjet e tjera për ushtrimin e besimit fetar duhet të dorëzohen tek Staatskanzlei e Landit të Nordrhein-Westfalen . Për këtë qëllim, kishat dhe komunitete të tjera fetare mund të na kontaktojnë këtu Referat_I_B3@stk.nrw.de.

Komunitetet të cilat i përkasin një organizate gjithëpërfshirëse janë të detyruar t'i koordinojnë planet e tyre për mbrojtjen nga koronavirusi me organizatën përkatëse gjithëpërfshirëse. Planet për mbrojtjen nga koronavirusi të komuniteteve fetare dhe shoqatave të cilat nuk janë të lidhura me ndonjë tjetër duhet t'i paraqiten komunës përkatëse.

A keni pyetje në lidhje me Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi? Atëherë na shkruani tek adresa e email corona@nrw.de